| | |
|---|---|
| **Emri i projektit:** | Qeverisje të përgjegjëshme në raport me të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (PAK) |
| **Kohëzgjatja:** | 01.06.2021 – 31.12.2021 |
| **Shtrirja gjeografike:** | Ferizaj |
| **Buxheti total i grantit (EUR):** | USD 10,960.00 |
| **Objektivat:** | Fuqizimi i rolit të personave me aftësi të kufizuara për të avokuar për zbatimin e Strategjisë Komunale dhe Planin e Veprimit për personat me aftësi të kufizuar dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, drejt përfshirjes së shtuar në politika lokale lidhur me personat me aftësi të kufizuara.<br><br>Përmirësimi i politikave publike lidhur me personat me aftësi të kufizuar dhe rritja e zbatimit të ligjeve dhe e strategjisë për personat me aftësi të kufizuara.<br><br>Rritja e angazhimit të komunitetit të personave me aftësi të kufizuar në politikë-bërje dhe planifikim buxhetor në nivel lokal përmes zhvillimit/hartimit të Planit Avokues për zbatimin e Strategjisë komunale për personat me aftësi të kufizuar. |
| **Grupet e synuara:** | Përfituesit kryesorë janë personat me aftesi te kufizuar dhe familjaret e tyre si dhe institucionet e Kosovës dhe do të mbeten të njëjta nëse do të mbështetët programi I propozuar. Përmes takimeve me palet e interesit do të përfshihen grupe e ndyshme të qytetareve si Assambleistët, Deputetët, Drejtoritë relevante, Partit politike, Këshilltarë komunal, drejtorite relevante, deputet te parlamentit, Kryesuesen e kuvendit, Kryetarin e Komunës të cilët do të konsiderohen si përfitues indirekt. |
| **Përmbledhje e grantit:** | Projekti synon angazhimin e organizatës, stafit, personave me aftësi të kufizuar dhe familjarëve të tyre si dhe grupet e ndryshme të interesit, në rritjen e përgjegjëshmërisë së qevererisje lokale në raport me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar. Handikos Ferizaj përmes këtij projekti do të monitorojë dhe avokojë për zbatimin e ligjeve dhe strategjisë komunale për personat me aftësi të kufizuar, duke rritur pjesmarrjen e tyre si akter të rëndësishëm të ndryshimit dhe për të vepruar dhe kontribuar në zhvillimet kryesore shoqërore. Poashtu, Handikos Ferizaj do të angazhohet në vlerësimin e situatës aktuale të qevererisjes lokale në raport me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe i cili vlerësim do të shërbej për të ndërmmarë veprime në rritjen e përgjegjëshmërisë së qeverisë lokale. |
| **Donatori:** | USAID në Bashkëpunim me Komunitetin (CCA*)* |